



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



Drejtoria e Arsimit

Nr. 571/23

Datë: 04-07-2023

Bazuar ne nenin 62 paragrafi 3 te Ligjit nr. 03/L - 040 për vetëqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës se Kosovës”, nr. 28/2008), nenin 52 paragrafi 4 i Statutit te Komunës se Vushtrrisë, 01. nr. 110-391, dt. 25.2.2010, si dhe bazuar ne ligjet qe rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji nr. 02/L-52, Ligji nr.03/L-068, Ligji nr.04/L-32 dhe Ligji nr.04/L-138), dhe me qellim te mënjanimit te subjektivizmit, jo profesionalizmit dhe familjarizimit me rastin e pranimi te fëmijëve ne institucionet parashkollore (IP) publike te Komunës se Vushtrrisë, drejtori i Drejtorisë Komunale te Arsimit (DKA) merr këtë:

VENDIM

**PER KRITERET E PRANIMIT TE FEMIJEVE NE INSTITUCIONET
PARASHKOLLORE PUBLIKE**

1. Vetëm fëmijët e prindërve qe janë banore te komunës se Vushtrrisë mund te regjistrohen ne institucionet parashkollore (IP), te Komunës se Vushtrrisë.
2. Planifikimin për numrin e fëmijëve qe do te pranohen ne IP e bëjnë vete IP-te, ne përputhje me legjislacionin ne fuqi dhe ne përputhje me kapacitetet profesionale dhe infrastrukturore te IP-ve.
3. Mosha minimale e fëmijëve dhe grup moshave qe do te pranohen ne IP e përcaktojnë vete IP-te, ne përputhje me legjislacionin ne fuqi dhe ne përputhje me kapacitetet profesionale dhe infrastrukturore te IP-ve, por llogaritja e moshës se fëmijëve nuk behet duke marr parasysh datën e regjistrimit por datën e fillimit te shërbimit, përkatësisht duke marr parasysh **datën 1 shtator**.
4. Pranimi i fëmijëve ne IP behet ne baze te numrit me te madh te pikëve totale qe merr një kandidat bazuar ne kriteret e specifikuara ne tabelën e mëposhtme;

Nr.	Kategoria	
1	Fëmijët bonjake pa te dy prindërit	100
2	Fëmijët bonjake pa njërin prind nëse prindi kujdestar është i punësuar	90
3	Fëmijët bonjake pa njërin prind nëse prindi kujdestar është i papunësuar	80
4	Fëmijët e invalidëve te luftës se UÇK-së nëse te dy prindërit punojnë	40
5	Fëmijët e invalidëve te luftës se UÇK-së nëse njeri prind punon	30
6	Fëmijët e invalidëve te luftës se UÇK-së nëse asnjeri prind nuk punon	20
7	Fëmijët me nevoja te veçanta nëse te dy prindërit punojnë	80
8	Fëmijët me nevoja te veçanta nëse njeri prind punon	60
9	Fëmijët me nevoja te veçanta nëse asnjeri prind nuk punon	40
10	Fëmijët e prindërve te divorcuar nëse prindi kujdestar është i punësuar	60
11	Fëmijët e prindërve te divorcuar nëse prindi kujdestar është i papunësuar	30
12	Fëmijët e veteraneve te luftës se UÇK-së -se nëse te dy prindërit punojnë	20
13	Fëmijët e veteraneve te luftës se UÇK-së nëse njeri prind punon	15
14	Fëmijët e veteraneve te luftës se UÇK-së nëse asnjeri prind nuk punon	10
15	Fëmijët qe punojnë te dy prindërit (me te ardhura mujore te prindërve deri ne 350 euro)	40
16	Fëmijët qe punojnë të dy prindërit (me te ardhura mujore te prindërve 351-700 euro)	30
17	Fëmijët qe punojnë te dy prindërit (me te ardhura mujore te prindërve 701-1000 euro)	25
18	Fëmijët qe punojnë te dy prindërit (me te ardhura mujore te prindërve mbi 1000 euro)	20
19	Fëmijët e prindërve qe janë banues ne lagjen - Bashkësinë Lokale ku gjendet IP-ja	20
20	Fëmijët e punëtoreve te IP-ve	10
21	Fëmijët e prindërve qe tashme e kane një fëmije vijues ne IP	10
22	Fëmijët qe njeri prind ju punon (me te ardhura mujore te prindit deri ng 350 euro)	20
23	Fëmijët qe njeri prind ju punon (me te ardhura mujore te prindit 351 - 700 euro)	15
24	Fëmijët qe njeri prind ju punon (me te ardhura mujore te prindit 701 - 1000 euro)	10
25	Fëmijët qe njeri prind ju punon (me te ardhura mujore te prindit mbi 1000 euro)	5

5. Te gjitha statutet e te gjitha kategorive te përfshira ne tabelën e mësipërme duhet te dëshmohen me dokumente valid te lëshuara nga institucionet relevante.

6. Ky vendim hynë ne fuqi menjëherë.

Vendimi i dërgohet:

1x1 IP"Foleja-1"

1x1 IP"Foleja-2"

1x1 IP"Foleja-3"

1x1 Arkivës




Dardan Abazi
Drejtör i DKA-së